



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Nr.63/18
Datë: **10 Tetor 2018**

Në mbështetje të nenit 28, 54 paragrafi (1) nën paragrafin 1.9, dhe nenit 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, tutje ref. **Autoriteti** duke pasur parasysh kërkesën e Telekomit të Kosovës SH.A tutje ref. **TK** të bëjë vlerësimin e objektit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e lidhur ndërmjet operatorëve ekonomik Ipko Telecommunication L.L.C. tutje ref. **Ipko** me Digit Alb SH.A. tutje ref. **DigitALB** në mënyrë që të analizohet dhe vlerësohet nëse ka ndikim mbi konkurrencën në treg, andaj në mbledhjen e mbajtur me **10 Tetor 2018**, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës merr këtë:

V E N D I M

- I. Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 54 par. 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, mbyllë procedurën hetimore të hapur me Konkluzion nr. LM/001/2018 të dt. 10.01.2018, lidhur me vlerësimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit “*Për Shpërndarjen e Kanaleve të Ofruara nga DigitALB në Platformën Kabllore IPKO*”, e datës 1 Prill 2014, dhe vendosi se nuk është ç’rregulluar konkurrenca e tregut në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229.
- II. Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës konstaton se Marrëveshja e bashkëpunimit **nuk** përmban kufizimin e të drejtës së blerësit për të **përcaktuar çmimin e shitjes së produktit**, pa cenuar të drejtën e furnizuesit që të përcaktoj çmimin maksimal të shitjes ose rekomandon çmimin e shitjes, me kusht që të mos jetë fjala për çmime fiks ose minimale të shitjes, e që është rezultat i presionit ekzekutues ose stimulues të ndonjëres palë kontraktuese.
- III. Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës konstaton se Marrëveshja e bashkëpunimit **nuk** bënë **kufizimin e zonës** në të cilën blerësi pjesëmarrës në marrëveshje mund të shesë produktet e të cilat janë objekt i marrëveshjes, ose të kufizojë shitjen e produkteve të kontraktuara për një grup të veçantë të konsumatorëve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

ARSYETIM

1. Iniciativa për të filluar procedurën e cila është kompetencë e Autoritetit, kërkesën, propozimin, kundërshtimin ose ndonjë paraqitje tjetër në formë të shkruar, mund ta paraqesë çdo person fizik apo juridik, shoqatë profesionale ose ekonomike e interesit, oda ekonomike, shoqatat e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, organet e administratës publike, qendrore dhe ato lokale.
2. Pretendimet janë se kjo kontratë ka tipare të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 të Ligjit 03-L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke pamundësuar konkurrencën në mes të operatorëve legal të licencuar në tregun përkatës.
3. Po ashtu paraqitësi i iniciativës pretendon se Ipko ka pozitë dominuese në tregun përkatës sipas nenit 10 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
4. Ndër tjera, paraqitësi i iniciativës kërkon nga Autoriteti që të vlerëson nëse ekziston Abuzimi me Pozitën Dominuese.

PROCEDURA E NDJEKUR NGA AUTORITETI

5. Për t'i vërtetuar këto pretendime të paraqitësit të iniciativës *Telekomi i Kosovës*, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke u bazuar në nenin 34, 35 dhe 36 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ka hapur procedurë hetimore me Konkluzion nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018 kundër ndërmarrjeve DigitALB dhe IPKO.
6. Në Konkluzionin me nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka kërkuar nga këto dy ndërmarrje, që Autoritetit t'ia ofrojnë të gjitha informatat e nevojshme (Marrëveshjen Ekskluzive – Kontratën) dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për vlerësim.
7. Gjithashtu me datë 10.01.2018, Autoriteti përmes një shkrese nr.08/18-02/D ka njoftuar paraqitësin e kërkesës për fillimin e procedurave hetimore.
8. Me datë 11.01.2018 me nr. Prot. 11/18-01/H Autoriteti ka pranuar kërkesën e IPKO Telecommunication, përfaqësuar nga Dastid Pallaska, avokat, me të cilën ka kërkuar zgjatjen e afatit për paraqitje të komenteve dhe dokumenteve në lidhje me konkluzionin nr. LM/001/2018 të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës të datës 10.01.2018.
9. Me datë 18.01.2018 në shkresën me nr. Prot. 18/18-01/H DigitAlb ka bërë kërkesë për zgjatjen e afatit lidhur me paraqitjen e komenteve dhe dokumenteve lidhur me konkluzionin me nr. LM/001/2018 të komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të datës 10.01.2018.
10. Me datën 12.01.2018 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka nxjerrë konkluzion me nr.13/18-02/D me të cilin është lejuar kërkesa e Ipko Telecommunication lidhur me zgjatjen e afatit prej 30 ditësh për paraqitje të komenteve dhe dokumentacionit të kërkuar sipas Konkluzionit me nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018
11. Me datën 18.01.2018 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka nxjerrë konkluzion me nr.19/18-02/D me të cilin është lejuar kërkesa e DigitAlb Sh.A. lidhur me zgjatjen e afatit prej 30 ditësh për paraqitje të komenteve dhe dokumentacionit të kërkuar sipas Konkluzionit nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018

12. Me datën 16.02.2018 me nr. 71/18-01/H, Autoriteti ka pranuar komentet paraprake dhe dokumentet në lidhje me konkluzionin për fillimin e procedurës me nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018 nga Kompania Ipko me përfaqësues ligjorë z. Dastid PALLASKA.
13. Me datën 21.02.2018 nr. 79/18-01/H, Autoriteti ka pranuar komentet paraprake dhe dokumentet në lidhje me konkluzionin për fillimin e procedurës nr. LM/001/2018 i dt. 10.01.2018 nga Kompania DigitALB me përfaqësues ligjorë Alban JAHO.

PALET NË PROCEDURË DHE OBJEKTI I VLERËSIMIT

1. Duke i'u referuar kërkesës së paraqitësit të iniciativës dhe Konkluzionit nr. LM/001/2018 të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të datës 10.01.2018, palë në procedurë janë:
 - a. **IPKO Telecommunication L.L.C**, me adresë Lagjia Ulpianë, Zija Shemsiu Nr.34, Prishtinë me nr. Regjistrimit të biznesit 70064420.
 - b. **Digit Alb S.H.A-** Dega Kosovë – Prishtinë, adresa Rr.Luan Hradinaj, Pallati i Rinisë p.n, me Nr. regjistrimi të biznesit 70906082,
2. Objekti i vlerësimit është Marrëveshje Bashkëpunimi “*Për Shpërndarjen e Kanaleve të Ofruara nga DigitALB në Platformën Kabllore IPKO*”, e datës 1 Prill 2014.

PËRCAKTIMI I TREGUT RELEVANT

1. Duke u bazuar në *nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011*, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës përcakton se:
2. Duke pasur parasysh se ky treg është i rregulluar, atëherë:
 - a. TREGU I PRODUKTIT është ofrimi i shërbimeve mediale audiovizuale.
 - b. TREGU GJEOGRAFIK konsiderohet të jetë territori i Republikës së Kosovës

PRETENDIMET E PARAQITËSIT TË INICIATIVES DHE KOMENTET E PALËVE NË PROCEDURË

Përshkrimi i rrethanave të rastit nga Parashtruesi i Kërkesës :

1. Ipko dhe Digit - Alb S.H.A për më tepër se 13 vite kanë të nënshkruar kontratë ekskluzive me të cilën Ipko është distributor ekskluzivë i produkteve të kompanisë Digit–Alb S.H.A, duke mos lejuar që asnjë operator tjetër i licencuar të ketë qasje në paketën e programeve Digit Alb, duke krijuar monopol në tregun përkatës dhe dëmtuar konkurrencën e lirë dhe të garantuar në treg.
2. Telekom i Kosovës, i cili posedon infrastrukturën më të zhvilluar të rrjetit të telekomunikimeve është përjashtuar nga gara e produkteve televizive .
3. Telekom i Kosovës është refuzuar nga prodhuesi Digit- Alb për mundësinë e blerjes për shkak të klauzolave kundërligjore që përmban kontrata me Ipko-n.
4. Kontrata ekskluzive komerciale është konfidenciale dhe nuk është e publikuar përveçse zyrtarisht janë deklaruar se Ipko është distributor ekskluziv i Digit Alb-it.

5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se bazuar ne Ligjin 03-229/për Mbrojtjen e Konkurrencës parashihet zbatimi si në vijim: ky Ligj zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë ndikim në Kosovë.
6. Parashtruesi i kërkesës, kërkon nga AKK që të vlerësoj nëse marrëveshja në fjalë bie nën zbatimin e nenit 5,6 dhe 7 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe të vlerësohen të gjitha elementet e konkurrencës dhe efektin e marrëveshjes në tregun e Kosovës.
7. Po ashtu parashtruesi i kërkesës konsideron se nëse kjo marrëveshje ka elemente që mund të konsiderohen të ndaluara sipas nenit 4 atëherë bazuar në nenin 9, kjo kompani duhet të kërkojë nga AKK përjashtim sipas neneve 5,6,7 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pas aplikimit për përjashtim Autoriteti do ta shqyrtojë aplikimin dhe do të hetoj çështjen e parashtruar në aplikim. Gjatë procedurës Autoriteti do të kërkojë edhe komente nga publiku dhe në veçanti nga konsumatorët dhe ndërmarrjet në tregun përkatës.
8. Bazuar në nenin 9 të Ligjit sipas paraqitësit të iniciativës IPKO është dashtë të aplikojë tek Autoriteti për përjashtim nga nenit 4 të Ligjit dhe se Autoriteti përcakton periudhën kohore gjatë të cilës përjashtimi mbetet në fuqi po jo më shumë se tre (3) vite.
9. Paraqitësi i kërkesës pretendon se palët në marrëveshje nuk e kanë kryer detyrimin për përjashtim në Autoritet, e kjo sipas tyre paraqet shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës
10. Paraqitësi i iniciativës pretendon se IPKO ka pozitë dominuese në tregun përkatës sipas nenit 10 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
11. Ndër tjera paraqitësi i iniciativës kërkon nga Autoriteti që të vlerëson nëse ekziston Abuzimi me Pozitën Dominuese.
12. Paraqitësi i iniciativës kërkon që, Autoriteti konform dispozitave të Ligjit të hulumtojë në detaje dispozitat e kontratës komerciale ndërmjet Ipko dhe Digit ALB e që sipas tyre kjo kontratë ka tiparet e marrëveshjes së ndaluar nga neni 4 pika 1,2 dhe 3 dhe abuzim me pozitën dominuese nga neni 11 i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës .

Komentet e Palëve në Procedurë

1. Ekskluziviteti i ofruar sipas marrëveshjes nuk paraqet IN PERSEI (në vetvete) as shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në përgjithësi dhe as marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të LMKsë në veçanti. Në lidhje me këtë është me rëndësi të theksohet se ekskluziviteti jo vetëm se nuk është një ndër elementet për të përcaktuar nëse një marrëveshje është e ndaluar sipas nenit 4 të LMKsë, por gjithashtu se të drejtat ekskluzive të transmetimit janë një prej shtytësve kryesor në tregun e transmetimit në Kosovë në përgjithësi dhe në tregun PAY TV në veçanti. Kjo vërtetohet nga trendet e tregut të cilët tregojnë se operatorët audiovizual përmes të drejtave të transmetimit për ngjarjet kryesore sportive kanë ndryshuar disa herë. Për më tepër Ipko nuk gëzon të drejta ekskluzive për transmetimin e kanaleve që kanë statusin e “bartjes së detyrueshme” dhe kësaj marrëveshje nuk shkel ndonjë element të interesit publik. Me qëllim të qartësisimit për Autoritetin, kanalet që kanë statusin e “bartjes së detyrueshme” janë të përcaktuara nga Komisioni i Pavarur i Mediave, si kanale kosovare me përmbajtje të përgjithshme si; lajmet, përmbajtjet edukative dhe të ngjashme për interesin publik. Këto kanale duhet të transmetohen nga të gjithë operatorët e licencuar, në mënyrë që të gjithë

përdoruesit/shikuesit të kenë qasje në to. Asnjë kanal nga Shqipëria nuk ka statusin e kanalit për “bartje të detyrueshme”.

2. Është me rëndësi të theksohet se shumica e të drejtave ekskluzive të transmetimit për ngjarjet kryesore sportive dhe /ose filmat kulmor ofrohen në baza të ekskluzivitetit. Si rezultat i kësaj, blerësit e këtyre të drejtave të transmetimit janë të detyruar në mënyrë kontraktuale që të ushtrojnë këto të drejta në baza ekskluzive. Për këtë arsye është absurde, që Telekom i Kosovës të kërkojë nga AKK të detyroj një blerës të ligjshëm dhe ekskluzivë të të drejtave të transmetimit që t'i shes ato të drejta një konkurrenti, në raste kur ky i fundit ka pas të drejtë që të blejë të drejtat e njëjta përmes procedurës së hapur dhe konkurruese të tenderimit e cila është organizuar nga prodhuesi i përmbajtjes në fjalë ose mbajtësi i të drejtave të transmetimit.
3. Në pretendimet e pabazuara TK përpiqet që në mënyrë të pasaktë të portretizoj DigitALB si prodhues të përmbajtjeve audiovizuele kulmore. Qëllimi i kësaj deklarate të pasaktë është vënja në lajthitje të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës se gjitha përmbajtjet audiovizuele të paketës DigitALB janë prodhim i vetë DigitALB. Duke bërë këtë, TK përpiqet që të shtyjë Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, që të mbrojë Telekomin e Kosovës, si konkurrent në tregun e transmetimit në Kosovë në dëm të konkurrentëve tjerë të ligjshëm dhe në këtë mënyrë të ç'rregullojë konkurrencën në këtë treg. Në të vërtetë siq është thënë qartë në pretendimet e pabazuara, Telekom i Kosovës kërkon nga AKK që të detyroj Ipkon dhe DigitALB që ti shesin të gjitha përmbajtjet audiovizuele të tyre edhe Telekomit të Kosovës. Kjo kërkesë bëhet nën pretendimin e pavërtetë se TK nuk ka të drejtë të kërkojë dhe të blejë përmbajtjen audiovizuele kulmore, e cila transmetohet në platformën kabllorë të Ipkos, nga vetë prodhuesit e kësaj përmbajtje audiovizuele kulmore.
4. Pretendimet e TK-së, që të vërtetojë se është ballafaquar me pengesa për të siguruar të drejtat e transmetimit të përmbajtjes audiovizuele që ofrohet në platformën kabllorë PAY TV të Ipkos-s, por po ashtu ka dështuar që të demonstrojë se të paktën është përpjekur t'i qaset këtij tregu. Në këtë drejtim, TK nuk ka ofruar asnjë informacion nëse ka marrë pjesë në ndonjë tender për të blerë të drejtat për transmetimin e ngjarjeve kryesore sportive apo filmave të njohur. Lënja jashtë e këtyre informacioneve nga ana e TK-se nuk është e pa qëllimshme. Kjo për faktin se – siq është theksuar më lartë- TK përpiqet që të vëjë në lajthitje AKK se DigitALB është vet prodhues i përmbajtjes audiovizuele e cila transmetohet në platformën kabllorë IPTV të IPKO-s. Është me rëndësi të theksohet se të drejtat e transmetimit për përmbajtjen audiovizuele kulmore, siq janë ngjarjet sportive, ofrohen për shitje në procedura të tenderimit të hapura dhe konkurrues. Siq mund të vërtetohet nga ftesa më e fundit për tender për të drejtat mediale ndërkombëtare për Ligën Spanjolle - La Liga, të vitit 2017 nuk ka asnjë pengesë të çfarëdollojshme që ndonjë nga palët e interesuara duke përfshirë TK-n, të marr pjesë dhe të bëjë ofertë për të blerë të drejtat e transmetimit. E njëjta procedurë e hapur dhe konkurruese ofrohet nga mbajtësit e tjerë të të drejtave të transmetimit të ngjarjeve kryesore sportive, siq është, Premier Liga Angleze, UEFA Champions League dhe Europa League, Bundesliga Gjermane, Lojrat Olimpikë, FIFA Kupa e Botës etj.
5. Tregu për blerjen e filmave operon në mënyrë të ngjashme. Përkatësisht të drejtat e transmetimit për filmat e prodhuar në Hollywood, ofrohen për shitje nga mbajtësit e të drejtave të transmetimit. Në të vërtetë DigitALB siguron të drejtat e transmetimit për filmat e Hollywoodit të cilët transmetohet në platformën kabllorë pay TV të Ipkos duke blerë këto të drejta për çmime të konsiderueshme. Në fakt siq mund të vërtetohet me Universal Studio, të drejtat e transmetimit të blera nga DigitALB për platformën kabllorë pay TV të Ipkos janë jo ekskluzive për dallim nga Shqipëria kjo tregon se nuk ka asnjë pengesë të vetme që cila do palë e interesuar, duke përfshirë TK të paraqesë ofertë për blerjen e të drejtave të transmetimit të filmave në baza ekskluzive apo për filma të cilat transmetohet nga platforma kabllorë pay TV e IPKO-se në bazë jo ekskluzive.

6. Platforma kabllore pay TV e Ipko-s përmban përmbajtje audiovizuale e cila prodhohet nga palët e treta për të cilat DigitALB ka siguruar të drejtat ekskluzive të transmetimit në tregjet ku këto të drejta të transmetimit ofrohen për shitje/blerje. Kjo është reflektuar në nenin 4 të Marrëveshjes me ç ‘rast DigitALB ka marrë detyrimin për t’i siguruar Ipko-s të drejtën ekskluzive të transmetimit të përmbajtjes Audiovizuale kulmore.
7. Neni 1. i Marrëveshjes parasheh se Ipko fiton të drejta ekskluzive për shpërndarje, në platformën e vet kabllore pay TV, të kanaleve të zgjedhura nga palët në procedurë, për të cilat DigitAlb do të siguroj/blejë të drejtat e transmetimit nga prodhuesit e përmbajtjes për territorin e Kosovës. Përkatësisht, siq parashihet me nenin 1. të Marrëveshjes përmbajtja Audiovizuale e transmetuar përzgjidhet nga Ipko dhe DigitALB dhe përfshinë por nuk kufizohet në kanale të platformës satelitore të DigitALB. Në këtë drejtim duhet të theksohet se i vetmi kanal i cili pjesërisht përmban prodhim të vet DigitALB është Kanali T. Të gjitha kanalet e tjera që përzgjidhen nga Ipko dhe DigitALB për qëllime të marrëveshjes përmbajnë përmbajtje audiovizuale që prodhohet nga palët e treta duke përfshirë kompanitë prodhuese filmike dhe/ose mbajtës të drejtave të transmetimit për ngjarje kryesore dhe të mëdha sportive. Është me rëndësi të theksohet se përmbajtja e platformës kabllore PAY TV që ofrohet nga Ipko është e ndryshme nga vetë platforma satelitore DigitALB në Shqipëri, e cila është e qasshme edhe në Kosovë nëpërmjet sinjalit satelitor. Vetëm si shembull, platforma satelitore DigitALB në Shqipëri nuk përmban Premier Ligën Angleze në format të plotë, e cila është një prej përmbajtjeve kryesore sportive që e dallon platformën kabllore Pay TV të Ipko’s nga konkurrentët e vet.
8. Mjetet e transmetimit nuk janë reciprokisht përjashtuese në kuptimin teknologjik. Përkatësisht një amvisëri mundet që njëkohësisht të ketë qasje në infrastrukturën e Cable TV dhe IPTV, gjatë kohës kur është duke pranuar sinjal direkt tokësor nga transmetuesit kombëtar, siç është RTK, KTV dhe RTV21. Përderisa Cable TV, IPTV dhe televizioni satelitor mund të qasen nëpërmjet kablllove, televizioni tokësor mund të shfaqet nëpërmjet nje antene të thjeshtë shtëpie në të njëjtin aparat televiziv.
9. Si rezultat i ngjashmërive të lartpërmendura, të gjithë ofruesit audioviziv në Kosovë, në parim janë të qeverisur nga një instrument i përgjithshëm ligjor, që është Rregullorja e KPM, Nr. 02/2017 mbi Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio Vizuale. Siq është theksuar qartë në neni 1. të Rregullores të KPM, ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale, fushëveprimi i Rregullores së KPM-së për ofruesit e shërbimeve mediale audio vizuale është të përkufizojë “kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marr parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejtë dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës”. Në bazë të kësaj mund të arrihet në përfundim se tregu për transmetim i Kosovës mbetet një treg i vetëm, pavarësisht mënyrës nëpërmjet të cilës përmbajtja audiovizuale transmetohet dhe/ose qaset nga konsumatorët e fundit.
10. Duhet të nënvizohet se edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka gjetur se ekskluziviteti – në vete- nuk paraqet shkelje të konkurrencës, në aktgjykimin e vet ne rastin Coditel (Rasti 262/81),. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka vendosur se “ një marrëveshje ku pronari i të drejtës së autorit të një filmi jep të drejtën ekskluzive për shfaqjen e atij filmi për një periudhë të caktuar në territorin e një shteti anëtar nuk i nënshtrohet, si i tillë, ndalesave të parapara në nenin 85 te Traktatit”. Si rezultat i kësaj marrëveshja nuk mund të cilësohet se shkel Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës vetëm për faktin se përmban ekskluzivitet të të drejtave të transmetimit për këtë arsye kërkesa e Telekomit që marrëveshja dhe klauzolat e veta të ekskluzivitetit të cilësohen si nule duhet të refuzohen në tërësi, si faktikisht dhe ligjërisht e pa-themeltë.

**ANALIZA MBI NDIKIMIN E KONKURENCËS SË
MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT
DIGITALB SH.A. – IPKO TELECOMMUNICATION LLC**

1. Për të vlerësuar Marrëveshjen e bashkëpunimit të ndërmarrjeve DigitALB dhe IPKO, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka përdorur nenin 3 par. 1.1 dhe nenin 66 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi: “Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën”.
2. Duke u bazuar në “Guidelines on Vertical Restraints” përkthyer në shqip (*Udhëzime mbi Kufizimet vertikale*) të Komisionit Evropian pika 96 – 229¹, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, e përcakton si **MARRËVESHJE VERTIKALE**,
3. Duke u bazuar në “Guidelines on Vertical Restraints” përkthyer në shqip (*Udhëzime mbi Kufizimet vertikale*) të Komisionit Evropian pika 96 – 229², format e Marrëveshjeve vertikale janë:
 - 3.1. Marrëveshje për një markë të vetme (Single branding) – Marrëveshja për Shitjen vetëm individëve me te njëjtën marke.
 - 3.2. Shpërndarje Ekskluzive (Exclusive distribution) – Marrëveshja për shpërndarje ekskluzive (për përjashtimin e te tjerëve ne hapësirën e caktuar gjeografike).
 - 3.3. Alokim ekskluziv i konsumatorëve (Exclusive customer allocation) -- Marrëveshja për Alokimin ekskluziv te konsumatorëve – (shitja vetëm një distributori për shitje te mëtutjeshme grupit te caktuar te konsumatorëve).
 - 3.4. Shpërndarje Selektive (Selective distribution) - Marrëveshja për shpërndarje selektive (jo te gjithë ndërmjetësuesve, por jo vetëm njërit).
 - 3.5. Franshiza (Franchising) – Marrëveshja për franshizën
 - 3.6. Furnizim Ekskluziv (Exclusive supply) – Marrëveshja për furnizim ekskluziv
 - 3.7. Kompensim për qasje në rrjetë (Upfront access payments) Marrëveshja për paradhënie (pages paraprake) – (avans) për qasje në rrjetë.
 - 3.8. Marrëveshjet e menaxhimit të kategorisë (Category management agreements) Marrëveshja e menagjimit te artikujve te ngjashëm - kategorisë
 - 3.9. Lidhjet (Tying) – Marrëveshja për shitjen e produkteve te lidhura – nëse dëshiron me e ble nje produkt atëherë je i detyruar me e ble edhe produktin tjetër.
 - 3.10. Marrëveshja e kufizimit te çmimeve të rishitjes (Resale price restrictions) - Kjo metodë përdoret kur shitësi ia shton disa vlera të ngjashme nga mallrat te cilat zotërohen prej ndërmarrjeve shoqëruese. ... Metoda e çmimit të rishitjes fillon me çmimin e lire (pa presion te përcaktuar) te rishitjes (të një malli të blerë nga njësitë ekonomike jo-te lira), duke minimizuar margjinën e ngjashme bruto.

KËSHTU QË:

1. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko ka si objekt që t’i jep të drejtën ekskluzive Ipkos’s të shpërndajë në platformën e vet kabllore kanalet të përcaktuar nga palët, pjesë e platformës DigitALB të cilat do të ofrohen nga DigitALB.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52010XC0519%2804%29>

² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52010XC0519%2804%29>

ANDAJ

2. Kjo **marrëveshje vertikale**, duke u bazuar në “*Guidelines on vertical restraints*” të Komisionit Evropian pika 2.2 paragrafi 151, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës e cilëson si **marrëveshje ekskluzive të shpërndarjes**, sepse në një marrëveshje ekskluzive të shpërndarjes, furnizuesi pranon të shesë produktet e tij vetëm për një distributor për rishitje në një territor të caktuar.³
3. Për të vlerësuar **Marrëveshjen Ekskluzive të Shpërndarjes** e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, nëse përmban dispozita të cilat kanë si objekt dhe pasojë disa kufizime të konkurrencës, Autoriteti duke u bazuar në “*Udhëzuesin mbi kufizimet vertikale*” të Komisionit Evropian pika 1.2 paragrafi 106 ka marr për bazë dhe analizuar “**Efektet Pozitive të Kufizimeve Vertikale**” dhe “**Efektet Negative të Kufizimeve Vertikale**”.
4. Ky udhëzues mbi kufizimet vertikale përpiqet të japë një pasqyrë të drejtë të justifikimeve të ndryshme për kufizimet vertikale. Arsyet e mëposhtme mund të justifikojnë zbatimin e kufizimeve të caktuara vertikale:

Terminologji e huaj për çështje të politikave të Konkurrencës

- a. To "solve a "free-rider" problem". – zgjidhja e problemit të shfrytëzimit falas (te të mirave publike (si të shpërndahet në mënyrë të barabartë kostoja)
 - b. To "open up or enter new markets" – Strategjia e hyrjes në tregjet e reja
 - c. The "certification free-rider issue" – Çështja e certifikimit të shfrytëzimit falas
 - d. The so-called "hold-up problem" - I ashtuquajtur problem i mbetur (ngurrimi për të bashkëpunuar me qellim që mos të fuqizohet bashkëpunëtori)
 - e. The "specific hold-up problem" – Problemi specifik i mbetur
 - f. The “vertical externality issue” - Çështja e shoqërimit (përcjelljes) vertikale (efektet ose pasojat anësore psh. Ndotja).
 - g. "Economies of scale in distribution"- Vëllimi (shkalla) i aktivitetit në shpërndarje
 - h. "Capital market imperfections" - Jo përkryerja e tregut të kapitalit (Të gjitha kufizimet të cilat e zvogëlojnë gamën e kontratave financiare që agjentët mund të nënshkruajnë dhe / ose që i pengojnë ata të bëhen të ndershëm quhen jo përkryerje. Këto kufizime janë më të zakonshme në tregjet e kapitalit).
 - i. "Uniformity and quality standardisation" – Standardizimi kualitativ i një trajtshëm
5. Kjo **Marrëveshje Ekskluzive e Shpërndarjes** e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, Autoriteti e justifikon si “*Uniformitet dhe standardizim të cilësisë*” dhe “*Ekonomi e shkallëzuar*”
 - a. *Uniformiteti dhe standardizimi i cilësisë*, në një kufizim vertikal mund të ndihmojë në krijimin e një imazhi të markës duke imponuar një shpërndarje të caktuar të uniformitetit dhe standardizimit të cilësisë, duke rritur atraktivitetin e produktit tek konsumatori përfundimtar dhe duke rritur shitjet e tijë (produktit).
 - i. Në rastin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes DigitAlb dhe IPKO, produktet e ofruara nga IPKO për konsumatorin përfundimtarë në territorin e Republikës së Kosovës ka rezultuar në përmirësimin e programeve audiovizuale cilësore, zhvillim apo inovacione të produkteve me çmime konkurruese në treg dhe ngritje të atraktivitetit të produktit. Gjithashtu këto dy ndërmarrje në platformën kabllore të IPKO-së kanë

³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52010XC0519%2804%29>

krijuar një imazh të brendeve apo markave të tyre me të cilat kanë ngritur besueshmërinë tek konsumatorët, e gjithë kjo si rezultat i “Uniformitetit dhe standardizimit të cilësisë.”

- b. *Ekonomitë e shkallës* - Për të shfrytëzuar ekonomitë në shkallë dhe për të parë një çmim më të ulët për produktin e tij, prodhuesi apo furnizuesi mund të dëshirojë të përqendrojë rishitjen e shërbimeve apo produkteve të tij në një numër të kufizuar shpërndarës.
- i. Në rastin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes DigitAlb dhe IPKO - Marrëveshja vertikale mund të arsyetohet si “*Ekonomitë e shkallës*”, duke e bërë kufizimin e një numri të distributorëve të caktuar, p.sh. përmes përzgjedhjes selektive të distribuimit i’u mundësohet prodhuesit apo furnizuesit për arritjen e “*ekonomisë së shkallëzuar*” duke i’u mundësuar atij të caktoj çmimin më të ultë të shitjes me pakicë për produktin e tij, sepse përmes marrëveshjeve vertikale prodhueseve apo furnizuesve i’u mundësohet më lehtë të futen në tregje të reja. Nëse prodhuesi apo furnizuesi pretendon të futet në një treg të caktuar, p.sh. për të eksportuar në një shtet tjetër ai duhet që të sigurojë një lloj mbrojtje “*Territoriale*” distributorit për shkak të investimeve që distributori ka bërë me kusht që ai produkt apo shërbim të jetë i pranuar në tregun e ri.

NDËRSA

6. **Efektet negative në treg** që mund të rezultojnë nga kufizimet vertikale të cilat ligji i BE-së për konkurrencë synon t’i parandaloj janë si në vijim:
- a. Mbyllje të tregut anti-konkurrues e furnizuesve të tjerë ose blerësve të tjerë duke rritur barrierat për hyrje apo zgjerim. (*orig. anticompetitive foreclosure of other suppliers or other buyers by raising barriers to entry or expansion*).
- b. Nga kjo **Marrëveshje Ekskluzive e Shpërndarjes** e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, Autoriteti konsideron se **nuk** paraqet mbyllje (foreclosure) të tregut përkatës sipas pikës (a) të lartëcekur sepse në tregun përkatës të *ofrimit të shërbimeve mediale audiovizuale* bazuar në Adresarin e Operatorëve të Shpërndarjes të Licensuar në Kosovë e siguruar nga *Komisioni i Pavarur për Media*⁴ figurojnë tridhjetë e nëntë (39) operatorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës. Njëherazi nuk mund të konsiderohet mbyllje (foreclosure) e tregut përkatës sepse ndërmarrjet në marrëveshje nuk janë duke i:
- i. *dëmtuar konsumatorët*
 - ii. *duke rritur çmimet me shumicë të produkteve,*
 - iii. *duke kufizuar zgjedhjen e produkteve,*
 - iv. *duke ulur cilësinë e tyre ose*
 - v. *duke ulur nivelin e inovacionit të produktit.*

Si dhe mundësia e konsumatorëve për të lëvizur nga një operator kabllor në tjetrin nuk paraqet pengesa të ndrrimit të operatorëve kabllor nga konsumatori fundorë.

⁴ <http://www.kpm-ks.org/?faq=418&gjuha=1>

- c. Nëse *Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes* e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko do t'i kishte këto kufizime të lartëcekura atëhere do të mund të konsiderohet si kufizim i konkurrencës ndërmjet brendeve të ndryshme (inter-brand competition)⁵.
- d. Inter-brand competition për brendin A mund të zvogëlohet, por konsumatorët kanë qasje në shërbime dhe çmime të ulta nga brendi B dhe C, të cilat kanë imazh të një cilësie të krahasueshme me brendin A.
- e. Në këtë treg ka shërbime të cilat mund të zëvendësohen plotësisht apo pjesërisht nga konsumatorët, e shërbime të cilat ofrohen nga tridhjetë e nëntë (39) operator tjerë të këtij tregu, për shkak të çmimeve, funksioneve, karakteristikave të kanaleve të transmetuara dhe të drejtat e transmetimit ose qëllimit të përdorimit të tyre brenda tregut përkatës. Kjo ka rezultuar me krijimin e një tregu njaft konkurrues dhe dinamik i cili ka ngritur kualitetin e shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve fundorë me çmime konkurruese të ndryshme.
7. *Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes* e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, **nuk** përmban kufizimin e së drejtës së blerësit (IPKO) për të përcaktuar çmimin e shitjes së produktit, pa cenuar të drejtën e furnizuesit që të përcaktoj çmimin maksimal të shitjes ose rekomandon çmimin e shitjes, me kusht që të mos jetë fjala për çmime fikse ose minimale të shitjes, e që është rezultat i presionit ekzekutues ose stimulues të ndonjëres palë kontraktuese.
8. *Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes* e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, **nuk** përmbanë kufizimin e zonës në të cilën blerësi pjesëmarrës në marrëveshje mund të shesë produktet e të cilat janë objekt i marrëveshjes, ose të kufizojë shitjen e produkteve të kontraktuara për një grup të veçantë të konsumatorëve.
9. Por në këtë rast *Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes* e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko përmban kufizimin e blerësit të drejtpërdrejtë shitjen aktive në territorin e ndarë ekskluziv ose grupit blerës ekskluziv të rezervuar për vetë furnizuesin, respektivisht në zonë ose blerësve të cilëve furnizuesi iu ka ndarë blerësve tjerë, me kusht që këto kufizime të imponuara nga furnizuesit, nuk e parandalojnë rishitjen nga blerësit indirekt dhe *Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes* e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko përmban kufizimin blerësit, i cili operon në nivel me shumicë, shitjet aktive⁶ dhe pasive⁷ për përdoruesit e fundit, e që nuk konsiderohet ndalim i kufizimeve vertikale sipas qëllimit që kanë. Është shumë e pazakontë që një prodhues të shesë produktet e veta konsumatorit fundor, me që rast përmes *Marrëveshjes Ekskluzive të Shpërndarjes* prodhuesi apo furnizuesi hyn në marrëveshje kontraktuale me furnizuesin për t'ia shpërndarë produktin/shërbimin e tij.
10. Duke u bazuar në neni 10 pika 1 par. (a) të Udhëzimit Administrativë Nr. 03/2017 *Mbi Përjashtimet Grupore të Marrëveshjeve Vertikale të Ndërmarrjeve*, nëse marrëveshja e bashkëpunimit përmban detyrimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të konkurrencës kohëzgjatja e të cilave është e pakufizuar ose tejkalon **pesë vjet**, respektivisht të cilat përsëriten në mënyrë të heshtur, konsiderohet se kanë qenë të

⁵ <http://www.concurrences.com/en/glossary-of-competition-terms/brand-competition-en>

⁶ **Shitje Aktive** - nënkupton kërkesën aktive dhe afrimin blerësve ose një grupi të caktuar të blerësve të cilët janë të vendosur vetem në territorin e furnizuesit tjetër, lidhjen e kontratave individuale dhe marrëja e masave për afrimin e produkteve atyre blerësve, si dhe krijimin e degëve, magazinimit apo organizimit e rrjeteve shpërndarëse dhe reklamat në territorin e një shpërndarësi tjetër. Me qasje aktive konsiderohet vizita e konsumatorit, dërgimi i postës blerësve, duke përfshirë edhe postën elektronike, reklamat në media dhe informacione të tjera publike të destinuara ekskluzivisht për këtë grup të blerësve apo grupit të blerësve në territorin ekskluziv të shpërndarësit tjetër

⁷ **Shitje Pasive** - nënkupton përgjigjanë kërkesën e blerësit individual, duke përfshirë shpërndarjen e produkteve blerësve të tillë, me rekomandim që i përgjigja e tillë nuk guxon të jetë pasojë e veprimeve të shitjes aktive. Me shitjen pasive konsiderohen edhe reklamat e përgjithshme ose promovimi në media apo në internet që arrin jashtë territorit ekskluziv të ndokujtë ose të ndonjë grupi të caktuar blerësisht, e që është rezultat i zhvillimit të teknologjisë, respektivisht lehtësimin në qasje, e që konsiderohet mënyrë e arsyeshme e afrimit atyre blerësve ose grupeve të blerësve.

kontraktuara për një periudhë të pacaktuar cilësohen si **detyrime të ndaluara në marrëveshje vertikale**.

11. Ndërsa nëse ndërmarrjet DigitALB dhe Ipko kanë për qëllim që ta bëjnë kohëzgjatjen e kësaj marrëveshje pas datës së skadimit, janë të obliguara që të vetë – vlerësojnë, nëse marrëveshja e tyre i plotëson kushtet, sipas U.A. Nr. 03/2017 *mbi përjashtimet grupore të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve*.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk vepron nën presionin e konkurrentëve duke i mbrojtur ata.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës **mbronë konkurrencën e tregut** dhe jo konkurrentët.

Si përfundim, pas një analize dhe vlerësimit të Marrëveshjes Ekskluzive të Shpërndarjes e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko dhe dokumenteve përcjellëse, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës PËRFUNDIMISHT vlerëson se; Marrëveshja Ekskluzive e Shpërndarjes e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko **nuk** ç'rregullon konkurrencën e tregut përkatës, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente për çështje administrative.

(_____)

Valon Prestreshi
Kryetari i AKK-së

(_____) (_____) (_____) (_____)
Ahmet KRASNIQI Fatime S. HAZIRI Muhamed KRASNIQI Shaqir MORINA
Zv. Kryetar Anëtare Anëtar Anëtar

Me këtë Vendim të njoftohen:

- *Ipko Telekomunikation L.L.C - Prishtinë*
- *DigitALB Sh.A. – Prishtinë*
- *Telekomi i Kosovës Sh.A.- Prishtinë*
- *Arkiva*